



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.10.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

2.1 Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;

2.2 Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;

2.3 Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 14:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

¹ Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para.

- | | |
|---------------------------|-------------------|
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)*</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Arben Lila, Përfaqësues pranë EU4JUSTICE.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

2.1 Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;

2.2 Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;

2.3 Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Naureda Llagami: Atëherë, po fillojmë vijimësinë e mbledhjes.

Kalojmë tek çështja e parë e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve që kanë të bëjnë me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit për tre ndihmëset gjyqtare në Gjykatën e Lartë: për zonjën {...}, {...} dhe {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit

Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Gjyqtaret {...}, {...} dhe {...} janë caktuar në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Afati i komandimit ka qenë tre vjet dhe ka filluar më datë 20.10.2020.

Nga verifikimet që kemi bërë rezulton se është vendi për të bërë deklarinimin e përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtareve, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, në fund të afatit të komandimit, të caktuar sipas vendimeve të Këshillit nr. 432, 433, 435, datë 14.10.2020, pikërisht më datë 20.10.2023, pasi plotësohet afati trevjeçar.

Mbi këtë bazë Komisioni ka përgatitur projektvendimet për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtareve të përmendura më lart. Në një relacion kemi bashkëlidhur tre projektvendimet për secilën nga kandidatet përkatëse.

Faleminderit për vëmendjen.

Ky ishte relacioni.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhin në votim projekt-aktin e parë që ka të bëjë me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit për gjyqtaren znj. {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Gjykatën e Lartë në fund të afatit të komandimit, më datë

20.10.2023.

2. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, [...], si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë [...].

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë, që është i njëjti projekt-akt por që ka të bëjë me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit për gjyqtaren {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit për gjyqtaren {...} e cila edhe kjo kthehet në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet edhe ky projekt-akt sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.10.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017-2019”, relatore znj. Yllka Rupa.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 14:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)*
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

² Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jastë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Arben Lila, Përfaqësues pranë EU4JUSTICE.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”, relatore znj. Yllka Rupa.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, periodha 2017-2019. Relatore znj. Yllka Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatores në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, do paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional që ka për qëllim vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtares në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale.

Kjo shkallë aftësie ndiqet nga një pikëzim mbi të cilin përcaktohet niveli i vlerësimit për çdonjërin nga katër kriteret e vlerësimit, si dhe ai i përgjithshëm, të cilët i propozohen për miratim mbledhjes plenare.

Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares hartohet bazuar në parashikimet e neneve 68, 89 e vijues dhe 93 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera nënligjore të

pranuara dhe të marra nga KLGJ. Me qëllim përcaktimin e shkallës së aftësisë së gjyqtarës për çdo tregues, është bërë një analizë e integruar të të gjitha të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit, ashtu sikundër ato përshkruhen në mënyrë të detajuar në raportin analitik të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, me të cilin tashmë ju jeni njohur.

Kjo procedurë vlerësimi ka filluar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.177, datë 29.04.2021, “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtarët pjesë e programit të vlerësimeve për vitin 2021”.

Në projektraport prezantohet e plotë ecuria e aspektit procedural sipas parashikimeve të ligjit “Për statusin”, kështu që unë do të ndalem në paraqitjen në mënyrë ezauruese të nivelit të vlerësimit dhe pikëzimit për katër kriteret e vlerësimit dhe komponentët përkatës.

Siç jeni në dijeni, gjyqtarja ka vlerësuar se ka vend për kundërshtime, që lidhen me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” si dhe “Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional”.

Analiza, qëndrimi dhe propozimi im si relatore i kësaj procedure do të evidentohet e integruar në analizën e komponentëve përkatës.

Mbështetur në analizën e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit do të prezantoj propozimin për nivelin e vlerësimit dhe pikëzimit për secilin nga kriteret e vlerësimit si dhe vlerëshmin e përgjithshëm.

Në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” – “Njohuritë ligjore”, 1.A.a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim. Në këto kushte propozohet në lidhje me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mirë në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me

karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i saj për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor. Në këto kushte, në lidhje me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Për të kaluar tek “Arsyetimi ligjor”, 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me këtë komponent duhet të vlerësohet shumë e lartë, pikëzimi 15 pikë.

Sa i përket 1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit. Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas rendit: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligji i zbatueshëm, vlerësimi i gjykatës dhe përfundimet e arritura nga gjyqtarja. Edhe në lidhje me këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit me 10 pikë.

Për sa i takon 1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, në secilin vendim të analizuar mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, duke pasuruar arsyetimin e vetë gjyqtarës. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkesave të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor. Në këto kushte, edhe lidhur me këtë komponent propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë dhe pikëzimi 25 pikë.

Kështu që, propozimi për nivelin e vlerësimit në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, “Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë”, aspekti 2.A.a. Respektimi i afateve ligjore. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 965 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi. Këto çështje i përkasin kategorive: “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Penale seancë

parapake” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se nga 965 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 329 prej tyre janë shqyrtuar në tejkallim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (329 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (965 çështje), gjyqtarja rezultojnë që të ketë gjykuar 34% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, do të përjashtoheshin çështjet ku afati ligjor është tejkalluar me një kohë relativisht të shkurtër (1 deri në 7 ditë), çështjet në të cilat vonesa për shqyrtimi ka ardhur si pasojë e shortimit me vonesë të tyre, si dhe çështjet të cilat janë shortuar në fund të muajit korrik dhe për pasojë, në kohëzgjatjen e tyre ka ndikuar leja vjetore e gjykatës në muajin gusht, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 179 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor, me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, rezultojnë të jetë 18.5 % të çështjeve të përfunduara te afatit ligjor.

Në kundërshtimet e saj, lidhur me këtë tregues gjyqtarja prezanton disa aspekte të punës të cilat kanë çuar në problematikat e konstatuara lidhur me afatet ligjore, të tilla si procedurat e shortit elektronik në Gjykatën e Tiranës dhe për këtë shkak gjyqtari gjykon një numër të konsiderueshëm çështjesh gjyqësore, çka rëndon kalendarin e punës së përditshme të gjykatës. Gjyqtarja pohon të ketë treguar kujdes dhe përkushtim maksimal në përfundimin e proceseve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm ligjor në kuadër edhe të gjykimit të drejtë dhe të rregullt ligjor.

Për shkaqe dhe rrethana të pavarura nga gjykata, kjo e fundit është detyruar të vijojë gjykimin me qëllimin e vetëm dhe të patjetërsueshëm për një hetim të plotë gjyqësor të drejtë, objektiv, të gjithanshëm, në arritjen e zgjidhjes ligjore të çështjeve në gjykim. Duke qenë, pohon gjyqtarja, se në vitin 2018 kam gjykuar 632 çështje nga 674 të shortuara dhe në 2019 – 498 dosje nga 508 të shortuara, unë vlerësoj se për këtë komponent propozon të vlerësohet në nivelin maksimal.

Në vlerësimin tim si relatore, situata e gjykimit të çështjeve në raport me respektimin e afateve ligjore duhet të vlerësohet edhe në kuadër të deklaramit të gjyqtarës, gjithashtu mbështetur edhe në përcaktimet e metodologjisë lidhur me trajtimin e rrethanave që nuk varen nga gjyqtari, por që ndikojnë në produktivitetin e punës së tij. Metodologjia parashikon mundësinë e një pikëzimi më të lartë për këtë komponent deri në pikëzimin maksimal.

Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin analitik rezulton se nga 965 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 329 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ose e përkthyer në përqindje 34% e çështjeve rezulton jashtë afatit ligjor. Kjo përqindje pikëzohet me 6 pikë. Mirëpo vlerësuesit kanë bërë një analizë më të thelluar të situatës, një analizë logjike, duke u mbështetur edhe në parashikimet e metodologjisë për të përjashtuar gjyqtarët nga penaliteti lidhur me vlerësimin për rrethanat që nuk varen prej saj. Kështu janë analizuar rrethanat të cilat kanë reduktuar në 18% nivelin e çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, duke rritur për rrjedhojë edhe nivelin e pikëzimit pra me 12 pikë.

Gjykoj se në këtë praktikë nuk ka vend për një vlerësim në nivel maksimal, duke ndjekur gjithashtu edhe një regjim të njëjtë për të gjitha praktikatat vlerësuese që rezultojnë të tilla situata. Në këto kushte, në cilësinë e relatores propozoj nivelin e pikëzimit për këtë komponent me 12 pikë.

Për të kaluar tek 2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe që analizohen në mënyrë të detajuar në projektraport, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në 89.9 % të çështjeve, duke u tejkaluar ky standard vetëm në 10.1 % të çështjeve. Referuar sa më sipër, propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

Për sa i takon 2.A.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, edhe lidhur me këtë tregues projektraporti paraqet të dhëna ezauruese për çdo kategori çështjesh dhe duke qenë se për të gjitha kategoritë e çështjeve koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, pra me 5 pikë.

2.A.ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit, si raport midis numrit të çështjeve të

përfunduara (1449 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara (1492 çështje) brenda vitit kalendarik, është 97%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke renditur si shkak që ka ndikuar në likuidimin e çështjeve, çështjet e regjistruara në ditët e fundit të vitit të cilat krijojnë një rritje të menjëhershme të numrit të çështjeve të regjistruara, të cilat nga ana tjetër nuk mund të gjykohen brenda atij viti, për shkak të kohës së mbetur, duke krijuar kështu një rezultat fiktiv negativ në përllogaritjen e efikasitetit në punë.

Nga ana tjetër, duke iu referuar edhe ngarkesës së punës për periudhën e vlerësimit (717 çështje me palë kundërshtare), si dhe faktit që për vitin 2017 gjyqtarja ka ushtruar detyrën për vetëm 6 muaj, e cila sjellë ndikimin e vet në llogaritjen matematikore të rendimentit, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal, me 10 pikë.

Për të kaluar tek 2.A.d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor. Ky tregues vlerësoj të klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, pasi vetëm për tre nënkategori çështjesh rezulton që afati procedural të jetë tejkaluar me 5, 6 dhe 18 ditë, ndërkohë që për të gjitha kategoritë e tjera afati i arsyetimit rezulton i barabartë ose më i shkurtër se afati procedural. Për rrjedhojë, propozoj vlerësimin e këtij komponenti me 15 pikë.

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore”, 2.B.a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Duke iu referuar të dhënave statistikore dhe vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.24 seanca dhe gjyqtarja përgjithësisht ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të tyre. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 15 pikë në lidhje me këtë tregues.

Për sa i takon 2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, përgjithësisht duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve

ndërgjyqëse. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 20.

“Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore”, 2.C.a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes. Rezulton se renditja akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 5 pikë.

Në lidhje me 2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes. Në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të “Letrës të të drejtave” e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim. Në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, projektraporti i vlerësimit propozon shkallën e vlerësimit mbi mesatare për gjyqtaren.

Gjyqtarja, ka paraqitur kundërshtimet në lidhje me këtë tregues, dhe ndër të tjera argumenton se nga ana e gjykatës gjithmonë është treguar kujdes që njoftimi të pandehurit ose viktimës së veprës penale për seancën e parë gjyqësore t’i bashkëlidhet “Letra e të drejtave”. Duke qenë se “Letra e të drejtave” bëhej vetëm në një kopje, e cila i bashkëlidhej njoftimit ajo nuk i kthehej më gjykatës pasi atë e mbante vetë i pandehuri/viktima e veprës penale, bashkë me njoftimin. Për këtë shkak nuk rezulton të jetë administruar “Letra e të drejtave” në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim, -pohon gjyqtarja.

Në lidhje me sa deklaron gjyqtarja, vlerësoj se trajtimi për ndryshimin e nivelit të vlerësimit ose të pikëzimit në lidhje me këtë tregues, duhet të jetë në përputhje me standardet që Këshilli ka mbajtur në të njëjtat situata pra duke mos e vlerësuar gjyqtarin maksimalisht për këtë komponent për të njëjtat arsye.

Kështu që propozoj që të mos ketë ndryshim në nivelin e pikëzimit lidhur me këtë tregues. Propozohet pikëzimi i gjyqtarës me 8 pikë.

Në këto kushte, propozimi për nivelin e vlerësimit në lidhje me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 95.

Në lidhje me kriterin tjetër “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për

të gjithë komponentët e këtij kriteri, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht, kështu që propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 100 për kriterin "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale".

"Aftësitë personale dhe angazhimi profesional" është kriteri i fundit mbi bazën e të cilës vlerësohet gjyqtarja. Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

"Aftësia e komunikimit", 4.A.a. Komunikimi i qartë dhe transparent. (25 pikë).

Nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegë dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta është shumë i lartë. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 15. (4.B.a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta).

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore, gjithashtu vlerësohet në nivelin maksimal, pikëzimi 10.

"Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera", 4.C.a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 12 aktivitete të zhvilluara për 16 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare të vlerësimit. Propozohet niveli i pikëzimit 20.

4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultonin të dhëna për angazhimin e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses apo trajnueses. Po ashtu, nuk rezultonin të dhëna për angazhimin e saj në udhëheqjen e kandidatëve për magjistratë gjatë periudhës së stazhit profesional.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast

vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari. Fillimisht u vlerësua se për gjyqtaren {...} duke qenë se nuk rezultonin të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues të pikëzohej me 3 pikë. Mirëpo në kuadër të kundërshtimeve dhe për të provuar vlerësim tjetër, lidhur me këtë komponent, gjyqtarja paraqiti një vërtetim të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datë 24.10.2022 me të cilën provon se ka qenë gjyqtare përgjegjëse, gjatë procesit të praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të vitit të dytë, për një nga kandidate për magistratë (bëhet fjalë për periudhën 2018, pra që është brenda periudhës së vlerësimit). Nisur nga ky fakt kam vlerësuar që gjyqtarja të marrë vlerësimin e plotë lidhur me këtë komponent, pasi provohet se ka udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë periudhës së vlerësimit. Në këto kushte propozohet ndryshimi i nivelit të pikëzimit nga 3 në 5 pikë.

Për sa i takon 4.C.c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata, referuar të dhënave nuk rezulton që gjyqtarja {...} të jetë angazhuar në veprimtari të tilla, kështu që niveli i pikëzimit për këtë tregues është 3 pikë.

Gjithashtu nuk rezulton nga ana e saj të ketë publikime ligjore dhe akademike, kështu që nuk vlerësohet lidhur me këtë tregues, pra është 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, për gjyqtaren {...}, është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 93.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter për këtë gjyqtare është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtares, pikët 100, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm.

Aftësitë organizative të gjyqtares, pikët 95, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 93, niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm.

Pra propozohet niveli i vlerësimit Shkëlqyeshëm, pikëzimi 388 pikë për gjyqtaren {...}.

Faleminderit për vëmendjen.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ndonjë diskutim?

Dritan Hallunaj: Në radhë të parë dua të komplimentoj për punën e bërë nga ana e nëpunësit dhe të gjithëve, por duke pasur parasysh se këtu kemi periudhën e vlerësimit 2017-2019 të gjyqtares {...} dhe unë dua të propozoj mbledhjes plenare, në pjesën e aftësive organizative të gjyqtares, “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, “Respektimi i afateve ligjore”, nga 12 pikë, që është vlerësuar, të vlerësohet me 15 pikë, pra me maksimalen e saj, për faktin se, është e vërtetë që të gjitha dosjet që janë shpërndarë sot në gjykatat tona janë shpërndarë me short elektronik dhe në varësi të asaj mund të jetë edhe ngarkesa në punë, por duke parë statistikën të cilat janë servitur, rezulton që për vitin 2018 i janë shortuar gjyqtares gjithsej 674 dosje dhe ka përfunduar 632, ndërsa për vitin 2019 i janë shortuar gjyqtares 508 dosje nga të cilat janë të përfunduara 498; vlerësoj që ky nivel duhet të jetë në nivelin maksimal, pra të shtohen edhe 3 pikë.

Gjithashtu, propozoj që në kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtares”, “Aftësitë e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore”, “Saktësia dhe plotësimi i dokumentacionit të dosjes” që është vlerësuar me 8 pikë, të shtohen 2 pikë, pra të jetë maksimale shumë e lartë, pra të vlerësohet me 10 pikë. Kjo për faktin që edhe siç u citua nga relatorja, u tha që bëhet fjalë për “Letrën e të drejtave” e cila i referohet neneve 34, 58, 137 e 140 të K.P.P., por duke qenë se letra e të drejtave realisht bëhet në një kopje dhe një kopje i jepet të pandehurit ose viktimës së veprës penale që rezulton që mund të mos ta paraqesë pranë gjykatës kur paraqiten, dhe për këtë pjesë nuk ka pse të penalizojë gjyqtaren. Prandaj unë propozoj që të rritet dhe niveli i saj të jetë “shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Këto janë. Për pjesën tjetër jam plotësisht dakord. Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Po, Irena!

Irena Plaku: Sa i përket propozimit të bërë nga z. Hallunaj, unë jam dakord vetëm për pikën e parë “respektimin e afateve ligjore”, pasi kam konstatuar se gjyqtarja ka gjykuar rreth 965 me afat ligjor dhe më pas, pasi i janë llogaritur çështjet të cilat... i

janë zbritur çështjet nga data kur janë llogaritur afatet nga data e shortit, sepse Gjykata e Tiranës ka problem sepse regjistrohesh në një datë tjetër dhe hidhet në short në datë tjetër. Gjyqtarit gjithmonë i shkon dosja pas shortit dhe mund të vonohet edhe një-dy ditë (të paktën nga praktika e gjykatës së Tiranës). Kështu që po t'i zbresim këto, siç është bërë edhe vetë llogaritja në projektraport, rezulton se numri i çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, nga 34 ka zbritur në 18,5%, përqindje e cila pikëzohet me 12 pikë. Po të mbajmë parasysh më pas numrin e çështjeve të gjykuara nga kjo gjyqtare (që kanë qenë me afat ligjor) dhe ngarkesën e saj e cila rezulton gati mbi 100% sepse ka gjykuar me palë kundërshtare 717, pasur parasysh dhe standardet që ne kemi shkuar gjithmonë me rritjen e dy niveleve (pasur parasysh se është shqyrtuar mbi 50% të çështjeve), jam dakord.

Ndërsa për sa i përket pikës së dytë që lidhet me “Letrat e të drejtave”, unë do isha dakord në rast se në fletëthirrje të ishte shënuar që bashkangjitur këtij njoftimi është edhe “Letra e të drejtave”, për sa kohë që nuk është, unë i qëndroj propozimit siç është bërë nga relatorja, me 8 pikë dhe jo me 10 pikë, pasur parasysh dhe të gjithë standardet që kemi mbajtur për gjyqtarët e tjerë të cilët i kemi ulur gjithmonë 2 pikë në rastin e mungesës dhe administrimin e “Letrave të të drejtave”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi disa propozime.

Kalojmë konkretisht. Fillojmë me propozimin e parë të zotit Hallunaj.

Propozimi i parë është nga 12 pikë në 15 pikë tek “Respektimi i afateve ligjore”.

Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Nuk jam dakord. I qëndroj propozimeve në projektraport.

Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet propozimi i parë i zotit Hallunaj.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozim i dytë që ka të bëjë me “Saktësia dhe plotësimi i dokumentacionit të dosjes”, nga 8 në 10 pikë. Propozimi i zotit Hallunaj.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i dytë i zotit Hallunaj.)

Naureda Llagami: Propozimi i fundit që është njohur nga relatorja për 2 pikët që e kemi të shtuar. Pra gjithsej i shtohen 3 pikë dhe 2 pikë, 5 pikë. Shkon në 391 në total. Kalojmë në tërësi të gjithë raportin me 391.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet raporti.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.10.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2020-2022”, (relatore znj. Brikena Ukperaj).³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 14:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)*
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

³ Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Arben Lila, Përfaqësues pranë EU4JUSTICE.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
8. *{...}, gjyqtare.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2020-2022”, (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë, raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarës {...}, e cila ka kërkuar që të jetë pjesë në seancën e shqyrtimit të projektraportit.

(Ftohet të hyjë në sallën e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}. Hyn në sallë znj. {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Kemi prezent magjistraten znj. {...}, e cila ka kërkuar që të jetë e pranishme në seancën kur shqyrtohet raporti i vlerësimit etik dhe profesional për të, për periudhën 2020-2022.

Procedura e Këshillit është që pasi i jepet fjala relatores e cila do të shpjegojë shkurtimisht raportin, më pas do t’ju jepet fjala juve, dhe ju do të jepni shkurtimisht gjërat të cilat, ju, i keni përcjellë në kundërshtimet tuaja, por që ju kërkon prapë që të dëgjohen dhe pasi të mbaroni edhe ju prezantimin e kundërshtimeve, do të largoheni nga salla për të lejuar Këshillin në vlerësimin e projektraportit tuaj.

Kështu që, pa humbur kohë, fjalën ia jap zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Procedura e vlerësimit etik dhe profesional e gjyqtares {...} i përket periudhës së vlerësimit 2020-2022, por dua të theksoj që në fillim që gjyqtarja nuk e ka periudhë të plotë vlerësimi për shkak se për një periudhë kohe ka qenë e shkëputur me leje barrë lindje, kështu që periudha është 2 vjet, një muaj, e disa ditë, dhe kjo ka sjellë që edhe numri i dosjeve që janë zgjedhur për short ka qenë i përpjesëtuar dhe janë marrë dosje në proporcion me periudhën e saj të vlerësimit.

Procedura ka filluar me vendimin nr. 173, datë 18.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pjesën e parë të projektraportit shpjegohet e gjithë ecuria e procedurës së ndjekur nga ana e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin deri në momentin e hartimit të raportit analitik, pastaj e komisionit dhe relatorit në hartimin e raportit të vlerësimit.

Projektraporti i vlerësimit i është njoftuar gjyqtares, anëtarëve; janë dhënë dhe kundërshtimet; nuk janë paraqitur prova të reja për t'u marrë në konsideratë; gjyqtarja ka kërkuar të dëgjohet në seancë dëgjimore.

Unë do ndalem në mënyrë të veçantë në treguesit e atyre kritereve për të cilat gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, duke qenë se për treguesit e tjerë vlerësimi ka qenë maksimal dhe nga ana e gjyqtares nuk ka pasur kundërshtime.

Për sa i përket “Aftësisë profesionale”, aspekti i parë i “Njohurive ligjore”, treguesi 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave. Konstatohet se gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes apo natyrës së çështjes apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale, i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsyetimit. Megjithatë këtu është për t'u evidentuar fakti që ka disa raste ku ecuria procedurale integrohet në pjesën e rrethanave të faktit, por këtë element do ta analizoj kur të analizoj qëndrueshmërinë e strukturës së dokumentit ligjor, pra të vendimit gjyqësor.

Në përfundim të këtij treguesi, duke analizuar metodologjinë e punës së gjyqtares në identifikimin e natyrës së mosmarrëveshjes, ligjin e zbatueshëm, qoftë atij material, qoftë atij procedural, si dhe dispozitave jo vetëm ligjore por edhe atyre të konventës, të

Kushtetutës, si dhe mungesës së evidentimit të një vendimi ku të ishte analizuar konflikti i normave, për këtë tregues kam arritur në konkluzionin që aftësia e gjyqtarës duhet të vlerësohet shumë e lartë me 25 pikë, pasi ajo shfaq përgjithësisht aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes së plotë të fakteve të çështjes. Në faktet me natyrë procedurale jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera nga gjyqtarja, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve. Edhe faktet thelbësore të çështjes janë paraqitur në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, të integruar provat e administruara në gjykim. Normat konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, identifikohen, citohen dhe analizohen në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Përcaktimi i qartë i natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizën ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Për sa i përket treguesit të dytë të kriterit të parë që ka të bëjë me 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre paraprak para se ato të aplikohen mbi faktet e çështjes. Përdor interpretimin kryesisht teologjik, duke identifikuar qëllimin e normës, por edhe interpretimin literal dhe sistematik të normave, duke përqasur kuptimin e saj me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave.

Në projektraport, në mënyrë analitike për të gjitha rastet, qoftë ligjin material ashtu edhe procedural, janë të zbërthyer çdo vendim gjyqësor, mënyra se si gjyqtarja dhe funksioni për të cilin gjyqtarja ka interpretuar normën përkatëse, qoftë në vendimet civile apo në ato penale.

Çfarë gjetje kam unë si relatorë në këtë tregues. Kryesisht është gjetur një aftësi jo shumë e lartë e gjyqtarës për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile por edhe atyre të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur që interferojnë në kompetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak. Konkretisht, në vendimet penale që kanë të bëjnë me gjykimin e çështjeve në seancë paraprake, gjyqtarja referon dhe interpreton nenin 329/a dhe 329/b të K.Pr.Penale për të mbështetur veprimet e gjykatës lidhur me veprimet paraprake për caktimin e seancës, njoftimin e prokurorit, njoftimin e viktimave dhe

personit nën hetim, si dhe vijimin e gjykimit pa praninë e viktimave të cilët kanë pasuri dijeni rregullisht për gjykimin dhe nuk janë paraqitur.

Megjithatë, në një prej vendimeve me të mitur në konflikt me ligjin, nuk vihet re që të jetë interpretuar, arsyetuar dhe argumentuar nëse nga ana e organit procedues prokuroria është përpiluar Raporti i Vlerësimit Individual, apo nëse ky mungonte, pse vetë gjykata nuk kishte urdhëruar kryerjen e tij, por ka disponuar me dërgimin e çështjes për gjykim në mungesë të këtij raporti. Raporti i Vlerësimit Individual është një akt i rëndësishëm, për t'u shqyrtuar nga organi procedues (gjyqtar i hetimeve paraprake, gjyqtar i seancës paraprake, gjyqtar i themelit, i) përpara se të merret një vendim lidhur me të miturin në konflikt me ligjin, konform neneve 22 e 47 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Mungesa e këtij akti, bën që vendimi përkatës për të miturin në konflikt me ligjin të mos përmbajë një arsyetim dhe argumentim miqësor dhe të ndryshëm nga ai që bëhet për të pandehur në moshë të rritur.

Kjo ishte për sa i përket interpretimit të dispozitave të Kodit për të Mitur në funksion të detyrave që ka gjyqtari i seancës paraprake.

Një gjetje tjetër lidhet me interpretimin e dispozitave të K.Pr.Civile, nenet 154, 154/a dhe 156 të këtij kodi, për të konkluduar se kërkesëpadia paraqitet me të meta, pasi provat shoqëruese nuk kanë qenë në formën e kërkuar nga ligji sipas gjyqtarës, janë paraqitur fotokopje (dhe jo njehsuara ose origjinale). Në këtë vendim palës paditëse nuk i është dhënë kohë për të plotësuar të metat e konstatuara, duke mos ezauruar kësisoj të gjithë procedurën e nevojshme për garantimin e së drejtës për akses në gjykatë dhe të drejtën për një proces të rregullt. Gjyqtarja ka marrë menjëherë vendimin pasi është njohur me padinë e aktet shoqëruese. Në këtë rast, nuk ka interpretuar pse ka zbatuar institutin e kthimit të menjëhershëm të padisë dhe jo atë për t'i dhënë mundësi palës për të korrigjuar të metat, duke qenë se të metat kanë qenë të korrigjueshme. Për këtë rast kam konstatuar që evidentohet një shmangie nga mënyra se si interpretohen e zbatohen dispozitat procedurale, të cilat lidhen ngushtësisht me garantimin e së drejtës së aksesit si pjesë e parimit të një procesi të rregullt ligjor.

Këto janë kryesisht dy gjetje kryesore që lidhen me mënyrën e interpretimit të ligjit procedural në zgjidhjen e çështjeve, të cilat pastaj kanë interferuar edhe pjesa e parimeve të përgjithshme të së drejtës, ku për sa i përket parimit të interesit më të lartë të fëmijës, në çështje ku përfshihen interesat e të miturit, konstatohet se nuk e kemi në atë

nivel kaq të lartë sikundër tek zgjidhjet e martesave zbatimin e këtij parimi tek çështjet penale me viktimë të mitur apo të mitur në konflikt me ligjin; pastaj edhe për sa i përket parimit të procesit të rregullt ligjor, e drejta e aksesit në gjykatë në çështjet civile kur disponohet për kthimin e padisë me të meta, duke mos i dhënë mundësi paditësit për t'i plotësuar këto të meta.

Bazuar kryesisht në këto dy modele vendimesh gjyqësore, kam konkluduar që për treguesin e aftësisë së gjyqtarës për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, shkalla e aftësisë të vlerësohet mbi mesatare sepse rezultoi se ajo përgjithësisht ka aftësi të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, por jo në të njëjtën masë kujdesi kur interpretohen e zbatohen dispozitat që lidhen me detyrat e gjyqtarit të hetimit paraprak në çështjet me të mitur në konflikt me ligjin si dhe të gjyqtarit të vetëm në momentin e paraqitjes së padisë e veprimeve paraprake në çështjet civile. Pavarësisht se bëhet fjalë vetëm për 2 çështje gjyqësore, ato janë tregues i aftësisë së gjyqtarës për të interpretuar ligjin procedural në të gjitha çështjet e të njëjtit lloj. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, shoqëruar nga identifikimi i praktikës gjyqësore.

Gjyqtarja është edhe vetë prezent dhe do ta shpjegojë më tej me kundërshtimet që ajo ka lidhur me këtë tregues. Unë qëndrimin tim do ta jap pasi të dëgjoj gjyqtaren. Shkurtimisht dua të prezantoj thelbin e kundërshtimeve të gjyqtarës lidhur me vendimin e kthimit të padisë pa veprime. Gjyqtarja pretendon dhe ka shkruar në fakt që interpretimi që është bërë nga ana e relatorit nuk përputhet me ligjin dhe ka referuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese e cila është investuar në një gjykim incidentar për të shfuqizuar nga Gjykata e Apelit Durrës për të shfuqizuar paragrafin e dispozitës që parashikon të drejtën e gjyqtarit për të kthyer padinë që në momentin e paraqitjes së saj dhe në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, është një vendim kolegji i cili nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim duke mos gjetur këtu cenim të standardeve kushtetuese, është parashikuar si një diskrecion i gjyqtarit nëse ai vendos të kthejë çështjen në moment apo duhet të përcaktojë të metat, t'ia komunikojë të metat. Megjithatë, unë nuk dua të zgjatem sepse gjyqtarja është vetë dhe mund ta sqarojë më saktë këtë.

Ndërkohë, për sa i përket çështjes së mungesës së raportit vlerësues në çështjen me të mitur në konflikt me ligjin, e ka pranuar që ky raport nuk ekziston, ndërkohë ka

pretenduar që Këshilli duhet të ketë parasysh praktikën e gjykimit të këtyre kategorive të çështjeve në gjykatën ku ajo ka ushtruar funksionin. Megjithatë mendon që një vendim i vetëm nuk mund të tregojë shkallën e aftësisë së saj dhe nga ana tjetër ka pretenduar që praktika për këto lloj çështjesh në gjykatën ku ajo ushtronte detyrën ishte minimale. Pasi të dëgjoj edhe gjyqtaren, kam edhe vetë disa pyetje për t'i drejtuar lidhur me këtë tregues dhe do jap edhe qëndrimin tim.

Për sa i përket treguesit tjetër 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, vlerësimi ka qenë maksimal nga ana ime si relatore, pasi kam konstatuar që gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së gjuhës së përdorur. E njëjta rëndësi është evidentuar edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsytim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes. Për qartësinë kam propozuar pikëzimin maksimal.

Për sa i përket 1.B.b Strukturës së qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, nga të gjitha burimet e vlerësimit, që janë kryesisht dokumentet ligjore është konstatuar që gjyqtarja jo gjithmonë ndjek në hartimin e vendimeve një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe atyre thelbësore, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Në vendimet gjyqësore të analizuar nga ana ime si relatorë është konstatuar se jo gjithmonë ka një metodologji të qartë në strukturimin e pjesëve përbërëse të vendimit dhe kam referuar edhe dokumentet ligjore ku është konstatuar kjo metodologji jo e qartë. Konkretisht struktura e vendimeve vizualisht mund të jetë e ndarë me tituj por në aspektin përmbajtjesor jo gjithmonë gjendet e pasqyruar ajo çka lexuesi ka pritshmëri të gjejë kur lexon titullin. Gjyqtarja jo gjithmonë bën një ndarje të qartë midis ecurisë procedurale dhe rrethanave procedurale nga rrethanat e faktit. Ka një miks në disa vendime sa që je duke lexuar për procedurë, pastaj shkëputesh tek fakti, pastaj kthehesh prapë për procedurë. Në një rast pikërisht për shkak të mosbërjes së kësaj ndarjeje, nuk kuptohet cilësia me të cilën gjykata ka disponuar për zëvendësimin e masës së sigurimit (gjyqtar hetimi paraprak apo gjyqtar seance paraprake), ndaj një personi që referuar arsytimit të vendimit (në projektraport është cituar edhe vendimi) rezulton të ketë marrë cilësinë si i pandehur, ndërkohë që në pjesën hyrëse pasqyrohet si palë e interesuar. Pavarësisht se përdorimi i termit “palë e interesuar” në pjesën hyrëse të

vendimit mund të jetë edhe një gabim material (është gjetur vetëm tek ky vendim në fakt), në kushtet kur subjektet procedurale në pjesën arsyetuese rezulton që ato emërtohen drejt, mosstrukturimi i pjesës përshkruese-arsyetuese, duke ndarë elementët procedurale nga rrethanat e faktit, zbeh kuptueshmërinë në tërësi të gjithë gjendjes së procedimit dhe fazën në të cilën është kërkuar dhe zëvendësuar masa e sigurimit. Ky ishte një rast.

Rasti tjetër lidhur me strukturën e vendimit, pavarësisht se vendimet e kanë të ndarë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese e arsyetuese (e cila ndahet në procedurë, rrethanat e çështjes dhe vlerësimi i gjykatës), lidhet me disa vendime civile, ku në to gjen të pasqyruar pretendimet e palëve para se të pasqyrohen rrethanat e faktit, një introvers. Duhet rrethanat e faktit dhe pastaj pretendimet, e bën më të kuptueshëm pjesën e vendimit nga ana e strukturës dhe mënyrës se si lexohet vendimi.

Ndërsa në pjesën e dispozitivit gjejmë të pasqyruar disponimin e gjykatës dhe datën e shpalljes. Përgjithësisht disponimi i vendimeve është i plotë (qoftë atyre civile ashtu edhe penale). Çfarë është konstatuar? Në një rast është konstatuar që në një çështje civile nuk është parashikuar e drejta e ankimit të veçantë për sa i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm (që është e dallueshme nga e drejta e ankimeve të tjera). Shpenzimet gjyqësore jo gjithmonë janë të llogaritura por në rastin e pjesës së pranimit të pjesshëm të padisë nuk janë saktësuar në masën se sa i ngarkohen palës humbëse. Ndërkohë që në vendimet penale përgjithësisht shikohet shënimi “shpenzimet lihen siç janë bërë”.

Përfundimisht, për sa i përket “Strukturës së dokumentave ligjorë”, në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit kam evidentuar se gjyqtarja ka aftësi mesatare në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor, por jo gjithmonë përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu dhe në atë përmbajtjesor. Mosndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, jo gjithmonë orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre. Duke vlerësuar aftësinë e gjyqtares mesatare, kam propozuar pikëzim me 6 pikë.

Edhe për këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime duke pretenduar që jo gjithmonë në hartimin e vendimit mund të ndiqet një strukturë e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar sepse çdo vendim ka natyrën e vet dhe për shkak edhe të pretendimeve që

ngrihen, nuk mund të ketë të njëjtën strukturë. Qoftë edhe nga kompleksiteti i çështjes pretendon gjyqtarja, një padi pronësie nuk mund të ketë të njëjtën strukturë me një padi vërtetimi fakti (sipas 388). Ka shpjeguar diçka lidhur me vendimin për “zëvendësim mase sigurimi”, por do na e thotë edhe vetë.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore në çështjet penale, pretendohet që llogaritja përpara përfundimit të procesit gjyqësor është e pamundur për shkak se deri në dhënien vendimit nga gjykata nuk ka shpenzime të llogaritura. Shpërblimi për avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata bëhet sipas një formulari të posaçëm dhe miratohet nga kryetari i gjykatës, për rrjedhojë nuk mundet gjyqtari të përlllogarisë paraprakisht këtë fakt. Shpenzimet gjyqësore në çështjet penale, u përlllogaritkan nga kryesekretaria. Nuk e di këtë. Dhe ekzekutohen së bashku me provat materiale. Vendimet gjyqësore në fakt sipas ligjit duhet të mbahen në mënyrë të saktë (qoftë penale, qoftë civile) sa janë shpenzimet gjyqësore.

Ka pretenduar që për pjesën e një strukture të qëndrueshme të mirëorganizuar, duhet të vlerësohet mbi mesatare.

Për sa i përket 1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, vlerësimi im si relatore lidhur me këtë pjesë është shkalla e aftësisë mbi mesatare, pikëzimi me 20 pikë. Vlerësimi bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarës në kuadër të këtij treguesi. Janë ndarë në projektraport mënyra e analizës dhe argumentimit logjik në çështjet penale dhe në çështjet civile. Është konstatuar që në një çështje civile (përmendet edhe vendimi me “footnote”), ka pasur një kërkesë nga pala “sigurim padie”. Kërkesa është miratuar nga gjyqtari i caktuar me short, pastaj gjyqtarja subjekt vlerësimi e ka marrë dosjen në shqyrtim me anë të shortit, e ka marrë në rishqyrtim për shkak të largimit të përlligjur të trupit të mëparshëm gjykues. Ka vazhduar gjykimin. Por nuk rezulton që të ketë disponuar lidhur me sigurimin e padisë (ç’është bërë me këtë sigurim padie?), as gjatë gjykimit dhe as në vendimin përfundimtar. Nëse nuk është ndryshuar, duhet të ishte ligjëruar masa e sigurimit të padisë.

Në këtë çështje, nga ana tjetër është evidentuar që argumentimi logjik në pamje të parë duket kontradiktor me mënyrën e disponimit të çështjes, pasi edhe pse nga gjyqtarja ka një analizë në fakt të detajuar të faturës së konsumit të energjisë elektrike si titull ekzekutiv dhe ka konkluduar se faturimi i dëmit ekonomik nuk mund të jetë element i faturës, ka arsyetuar: “...për faturën e dëmit ekonomik është përcaktuar në mënyrë të

qartë rruga ligjore për kundërshtimin e saj, afatet për paraqitjen e ankesës, organi kompetent që e merr në shqyrtim...”. Dhe pastaj ka disponuar për “rrezim padie”.

Në vlerësimin tim, në këtë rast kjo e bën shkallën e analizës dhe argumentimit logjik të cunguar.

Tjetër gjë që mund të them për pjesën e analizës dhe argumentimit logjik, ka një baraspeshim midis analizës së detajuar të provave dhe interpretimit të ligjit në mënyrë abstrakte e cila sigurisht që zë një peshë kryesore, zë peshë në arsyetim por nuk duhet të ishte ajo që zinte peshën kryesore, me pjesën ku gjyqtarja analizon mënyrën se si ligji zbatohet mbi faktet e provuara. Në dokumentet ligjorë spikat aftësia e gjyqtarës në drejtim të analizës së provave dhe interpretimit të ligjit, madje të dy këta komponentë zënë peshën më të madhe të arsyetimit të vendimeve. E njëjta rrjedhë logjike dhe cilësi analitike nuk spikat në çdo rast kur analizohet zbatimi i dispozitës mbi faktet e provuara, e cila është ajo që lidhet drejtpërdrejt me konkluzionin e arritur. Mund të themi që nuk ka ekuilibër midis pjesës përshkuese dhe asaj analitike, duke mos i dhënë më shumë rëndësi kësaj të fundit, duke ndjekur gjithmonë parimin që gjyqtarët nuk janë për të përshkruar por janë për të analizuar dhe për të vlerësuar. Peshën më të madhe në vendim duhet ta zërë pikërisht komponenti analitik, prandaj sasia e arsyetimit duhet të mbizotërohet nga pjesa analitike dhe argumentimi logjik se si dispozitat e interpretuara në mënyrë abstrakte dhe praktika gjyqësore zbatohet mbi faktet konkrete. Pala duhet të dijë se si zgjidhet çështja e tij.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, përgjithësisht gjyqtarja është ezauruese në shqyrtimin e prapësimeve apo edhe të pretendimeve të palëve.

Bazuar në të gjitha këto sa referova në mënyrë të përmbledhur (në projektraport janë përmendur në mënyrë më të zgjeruar), kam vlerësuar që aftësia e gjyqtarës lidhur me këtë tregues të vlerësohet “mbi mesatare”, për arsye se edhe pse ndiqet një rregull fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, nuk reflektohet e njëjta shkallë kujdesi në lidhje me argumentimin logjik se si dispozitat ligjore zbatohen mbi faktet e provuara.

Përfundimisht për katër treguesit e kriterit të parë propozimi im në projektraport ka qenë niveli i vlerësimit "Shumë mirë", pikët 86.

Dua të them që edhe për pjesën e cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik gjyqtarja ka bërë kundërshtime. Kryesisht është ndalur tek ajo çështje civile që unë

citova. Ka pretenduar që në fakt vendimin e saj e ka të bazuar në një qëndrim të Gjykatës së Apelit Shkodër, por nuk ka arritur që të gjejë vendimin për shkak se nuk ka aksesuar dot në sistem.

Për sa i përket kriterit të dytë “Aftësia organizative”, 2.A.a Respektimi i afateve ligjore. Duke qenë se gjyqtarja gjatë kësaj periudhe ka ushtruar funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, ajo ka pasur një ngarkesë shumë të vogël të çështjeve në shqyrtim. Në qoftë se më përpara kishim gjyqtarë me 90 çështje, çështje me afat ligjor ndoshta, kjo gjyqtare ka pasur për shqyrtim vetëm 77 çështje me afat ligjor të ndara respektivisht: 31 çështje në vitin 2020, 25 çështje në vitin 2021 dhe 21 çështje në vitin 2022.

Nga një llogaritje e thjeshtë matematikore bazuar në tabelat statistikore ka rezultuar që për 33 çështje vendimi është marrë në tejkalim të afatit dhe kjo përqindje përkon me 42.85% e çështjeve.

Duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga gjyqtarja në formularin e vetëvlerësimit për shkaqet që kanë ndikuar në mosrespektimin e afateve ligjore të cilat konsistojnë në garantimin e të drejtës së mbrojtjes efektive, kontradiktoritetit, hetimit të plotë e të gjithanshëm të tyre, njoftimit të tyre, kërkesat për marrje të provave, pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të masave anti-Covid duke marrë parasysh që viti 2020 ka qenë një vit gjatë të cilit është pezulluar veprimtaria gjyqësore, apo shkaqeve të tjera objektive të përmendura nga gjyqtarja, lejes së saj vjetore, raportit mjekësor sepse ka qenë edhe vetë e diagnostikuar me Covid, etj., është bërë një rianalizë e të gjitha të dhënave statistikore për aq sa kishim mundësi të evidentonim nga tabelat statistikore. Duke përjashtuar çështjet me afat ligjor, duke përjashtuar periudhën e lejeve vjetore, duke përjashtuar periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore apo edhe periudha të tjera të cilat interferojnë mbartjet e dosjeve në tejkalimin e këtij afati, janë të gjitha çështjet e analizuara në projektraport, dhe përfundimisht nga rillogaritja matematikore e përqindjes së çështjeve të shqyrtuara tej afateve ligjore, duke zbritur nga totali prej 33 çështje, 7 të cilat nga statistikat/tabelat që ne kishim, dukej që tejkalimi i afatit ose kishte qenë i papërfillshëm ose kishte qenë për shkaqe që nuk vareshin nga gjyqtarja, përqindja shkonte në 33.76% (pra ishin 26 çështje nga 77 të analizuara), përqindje e cila sipas metodologjisë përkonte me 6 (gjashtë) pikë.

Sipas kësaj metodologjie vlerësuesi duhet të bëjë, veç analizës matematikore,

edhe një analizë logjike të të dhënave statistikore, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në këtë rast, pavarësisht numrit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afat ligjor, rezulton se gjyqtarja kishte pasur një ngarkesë jo të lartë të çështjeve në periudhën 2 vjet, një muaj dhe 5 ditë që ishte dhe periudha e saj e vlerësimit, pasi siç e thashë kishte qenë e shkëputur me leje barrë lindjeje, dhe në total kishte gjykuar gjithsej për këtë periudhë 355 çështje, nga të cilat vetëm 197 çështje me palë kundërshtare. Duke marrë parasysh këtë ngarkesë të ulët të gjyqtares, vetëvlerësimin e gjyqtares me shkaqet objektive që kishin ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve, numrin jo të lartë të gjykimeve me afat ligjor, të cilat përbënin rreth 21.69% të çështjeve të shqyrtuara prej saj, kam vlerësuar që në analizë logjike nuk ishte vendi për të rritur nivel pikëzimi por duhet të mbeteshim në të njëjtin nivel pikëzimi të përcaktuar nga analizat e të dhënave statistikore dhe nga rianaliza e këtyre të dhënave matematikore duke hequr nga kjo analizë të gjithë periudhën, siç e përmenda, që nuk ishte përgjegjësi e gjyqtares, periudhën e pezullimit, periudhën e lejes, periudhën e raportit, etj., apo edhe ato çështje ku kishte tejkalim një apo dy ditë, duke hequr edhe periudhën nga data e regjistrimit deri në datën e rishortimit, se kishte raste kur çështja rishortohej.

Tani, lidhur me këtë, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime dhe ka sjellë në vëmendje të këtyre kundërshtimeve duke analizuar 20 dosje të tjera të cilat ne nuk i kemi burime vlerësimi. Në këto kushte, për sa kohë këto dosje nuk janë burim vlerësimi dhe në metodologji dhe në ligj detyrimi ynë është që nga përqindja e çështjeve që nuk respektohet afati ligjor të marrim një numër të kufizuar dosjesh, unë mendoj që të gjitha këto pretendime të gjyqtares, duke marrë parasysh që proceset zhvillohen mbi baza dokumentare, janë pretendime të cilat janë marrë parasysh në analizën e të dhënave statistikore paraprakisht nga ana ime si relatore, qoftë edhe kur është bërë raporti analitik nga ana e nëpunësit. Që të vlerësojmë të gjitha këto duhet që të gjitha 20 dosjet t'i analizojmë, por kjo nuk do të jetë punë efektive sepse gjyqtarja ka vetëm 38 çështje me afat ligjor. Çfarë do të thotë një gjyqtar që ka 900 çështje me afat ligjor? Çfarë bëjmë ne? Ne analizojmë të dhënat statistikore dhe marrim kampione nga dosjet që janë jashtë afateve ligjore. Nga analiza e dosjeve që kemi marrë nga jashtë afateve ligjore, nuk ka rezultuar ndonjë çështje e cila afati të jetë shmangur për shkaqe të rrethanave objektive. Prandaj për sa i përket “Respektimit të afateve ligjore” në këtë moment unë mund të jap edhe një konkluzion, që nuk jemi në kushtet kur mund të kemi një rritje të nivelit të

pikëzimit.

Për sa i përket 2.A.b Plotësimi të standardeve minimale kohore, këtu hapësira e vlerësuesit është më e gjerë se tek “Respektimi i afateve ligjore” sepse janë afate orientuese dhe pavarësisht se nga analiza matematikore dhe logjike e të gjitha të dhënave kanë dalë 16.9% të çështjeve jashtë standardit dhe sipas metodologjisë pikëzohej me 4 pikë, kam propozuar që t’i rritet një nivel pikëzimi, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje ka rezultuar sipas analizës që ka qenë më e gjatë se standardi vetëm për tre kategori çështjesh por kanë qenë kategori “Familjare pa palë kundërshtare, “Seancë paraprake – kërkesë për pushimin e procedimit penal”, “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit” dhe ka qenë i tejkalluar afati me 36 ditë, 7.8 ditë, 12.1 ditë. Kështu që kam propozuar që edhe për këtë tregues të kemi një rritje të nivelit të pikëzimit, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Rendimenti ka rezultuar në masën +99% (102% për saktësi). Pikëzimi me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit – pikëzimi maksimal me 15 pikë. Ajo duhet të klasifikohet si më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve pasi vetëm për katër nënkategori ka qenë e tejkalluar me 0.6 ditë, 0.2 ditë, 1.38 ditë dhe 2 ditë që janë tejkalime të papërfillshme. Për këtë arsye kam propozuar pikëzimin maksimal me 15 pikë.

Për sa i përket 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, nga analiza e përgjithshme e të gjitha dosjeve të cilat janë me palë kundërshtare dhe kanë kaluar në seanca gjyqësore, numri mesatar ka rezultuar tre seanca dhe përgjithësisht gjyqtarja ka marrë pasat për shmangien e seancave joproduktive. Për këtë arsye kam propozuar pikëzimin me 15 pikë.

Për sa i përket 2.B.b Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, sipas rregullave të gjykimit civil dhe penal.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes për marrjen e masave për njoftimin e

palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive, me përjashtim të një çështjeje me të mitur, ku rezulton se tri seanca janë shtyrë me qëllim njoftimin e psikologut si subjekt i detyrueshëm në proceset gjyqësore me të mitur në konflikt me ligjin. Vihet re se gjyqtarja nuk ka marrë paraprakisht masa për të qenë i pranishëm një psikolog asistues për të miturin që në seancën e parë, duke urdhëruar në vendimin për caktimin e seancës paraprake njoftimin dhe praninë e detyrueshme të subjektit psikolog. Megjithatë, rezulton se të gjitha veprimet procedurale janë respektuar dhe janë kryer brenda afateve procedurale. Është treguar kujdes në verifikimin e shkaqeve të mosparaqitjes, relatimit të tyre, ecurisë së zhvillimit të gjykimit, marrjes së vendimeve të ndërmjetme. Drejtimi i seancës gjithmonë është zhvilluar në bazë të urdhrave dhe vendimeve që kanë qenë të arsyetuara dhe të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse. Ka disa seanca të filluara me vonesë, por vonesat janë të papërfillshme.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer në përgjithësi me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor. Lidhur me mosmarrjen e masave për njoftimin e ekspertit psikolog në një çështjeje me të mitur në seancë paraprake, rezulton se kjo çështjeje ka sjellë një zvarritje të gjykimit në seancë dhe tejkalimin e afatit 30-ditor që parashikohet nga paragrafi i tretë i nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale për gjykimet në seancë paraprake me objekt “dërgim në gjyq” si dhe ka pasqyruar zhvillimin e katër seancave ku i mituri është përballur me organin procedues, ndërkohë që parimet e drejtësisë miqësore me të mitur lipsin një gjykim pa vonesa dhe të shpejtë. Nga ana tjetër vihet re se në seancën e datës 28.12.2020 gjyqtarja ka marrë vendim për legjitimimin e avokatit të caktuar kryesisht për të miturin në konflikt me ligjin pa praninë e psikologut, ndërkohë që për të miturin nuk mund të zhvillohet asnjë veprim procedural apo vendimmarrje pa pasur mbështetje psikologjike. Në kushtet kur jemi para mosrespektimit të disa aspekteve procedurale të rëndësishme që ndikojnë në drejtësinë penale për të mitur, vlerësoj që në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja duhet të vlerësohet me aftësinë mbi mesatare, duke u pikëzuar me 16 pikë.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja ka bërë kundërshtime, por në kundërshtimet e saj, ndoshta në mënyrë të gabuar (e quajmë lapsus) i është referuar një treguesi tjetër, i është referuar treguesit të aftësisë së gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore, por nga përmbajtja duket që në fakt i referohet këtij treguesi sepse, citoj, përmend se: “...në të

gjitha rastet ka marrë masa organizative për vendosjen e dosjes në lëvizje, ndërkohë që vetëm në një rast nuk është njoftuar psikologu asistues që në seancën e parë, por kjo nuk ka passjellë shtyrjen e katër seancave për këtë fakt, ashtu si parashtrohet në raport. Gjykata ka proceduar menjëherë me njoftimin dhe paraqitjen e detyrueshme të psikologut asistues por në gjykatën ku unë punoja gjithmonë kemi pasur vështirësi në paraqitjen e ekspertëve, pasi ata vinin nga larg dhe gjithmonë i parashtronin gjykatës seanca të mëparshme të planifikuara për shkaqe të cilat sillnin shtyrjen e seancave. Prandaj mendoj që vetëm ky rast nuk mund të ulë vlerësimin tim lidhur me aftësinë për kryerjen e veprimeve procedurale dhe për rrjedhojë edhe për këtë aspekt duhet të vlerësohem me aftësi shumë të lartë. ”

Për sa i përket 2.C Aftësisë së gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore (2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes) dhe aftësinë e gjyqtarit në drejtim të 2.C.b Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit, pikëzimi është maksimal sepse nuk janë gjetur të dhëna që mund të interferonin në një pikëzim më të ulët.

Përfundimisht, sipas projektraportit, për kriterin e dytë të “Aftësive organizative të gjyqtares”, kam propozuar nivelin e vlerësimit "Shumë mirë", pikët 87.

Për sa i përket kriterit të tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, duke qenë se burimet e vlerësimit për të gjithë këta tregues lidhen me njëri-tjetrin, në mënyrë të përmbledhur po përmend që nuk ka të dhëna për masë disiplinore. Nisur nga të dhënat e verifikimit të ankesave, ato nuk përmbajnë elementë që mund të konsiderohen në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional sepse ankesat kanë qenë të arkivuara kryesisht për sa i përket mënyrës së vlerësimit të çështjes nga ana e gjyqtares, që i përket gjykatave më të larta.

Lidhur me raportin e ILDKPKI-së për ekzistencën e saktësisë, plotësisë së deklaratave disavjetore dhe për sa i përket ekzistencës ose jo të konfliktit të interesit, të dhënat kanë qenë pozitive.

Ndërkohë gjyqtarja gjatë kësaj periudhe ka ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryetares dhe kemi vetëm të dhënat e vetëvlerësimit të saj, janë pozitive.

Prandaj për të gjithë treguesit e këtij kriteri të tretë vlerësimi ka qenë maksimal dhe pikëzimi tërësisht "Shkëlqyeshëm", niveli i pikëve 100.

Për “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, ka pikëzim maksimal për komunikim të qartë dhe transparent, për respektim të konfidencialitetit, për aftësi për të

bashkëpunuar, për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Këtu ka të dhëna për trajnime të cilat janë të shtrira në 15 ditë. Ka marrë pjesë në të gjithë këtë periudhë në 9 aktivitete, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 dhe 120 ditë. Pikëzimi me 20 pikë.

Nuk ka të dhëna për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnim. Nuk ka të dhëna për pjesëmarrje në veprimtari ndërinstytucionale dhe për publikime ligjore akademike. Prandaj dhe nuk është pikëzuar me pikët maksimale për këta tregues.

Përfundimisht për kriterin e katërt pikëzimi është 91 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Sipas projektraportit, në përfundim kam vlerësuar që për kriterin e parë të "Aftësive profesionale", gjyqtarja të vlerësohet "Shumë mirë" me pikët 86; për kriterin e dytë "Aftësitë organizative", gjyqtarja të vlerësohet "Shumë mirë" me pikët 87; për kriterin e tretë "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale", 100, "Shkëlqyeshëm"; për kriterin e katërt "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional", 91 pikë, "Shkëlqyeshëm". Përfundimisht, niveli i vlerësimit "Shumë mirë" me pikët 364.

Janë përpiluar në fund të projektraportit edhe disa propozime dhe rekomandime të cilat konsistojnë në rekomandim për angazhimin e saj në aktivitete trajnuese e gjyqtarëve, kryesisht në tema që lidhen me drejtësinë penale për të mitur, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstytucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale. Duhet t'i kushtojë më shumë kujdes respektimit të afateve ligjore, ndjekjes së një strukture të qëndrueshme dhe të organizuar të vendimit gjyqësor, si dhe saktësisë së dispozitivit me qëllim që vendimi të jetë i qartë dhe i zbatueshëm.

Kjo ishte në mënyrë konçize përmbajtja e projektraportit të vlerësimit.

Gjyqtarja është prezent. Unë relatova vetëm në mënyrë sintetike kundërshtimet e saj. Mund t'i paraqesë gjërat që ajo mendon që janë të rëndësishme për t'u marrë parasysh nga ana e Këshillit.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, shkurtimisht sepse jemi vënë në dijeni me çështjet që ju keni parashtruar përpara Këshillit. Nëse keni ndonjë gjë tjetër përveç këtyre.

{...}: Faleminderit për kohën dhe për mundësinë që më dhatë për t'u dëgjuar në këtë vlerësim timin të parë dhe për faktin që ishte vlerësimi im i parë unë e çmova të rëndësishme të vija këtu dhe të parashtroja qoftë vështirësitë që kisha hasur në punën time si magjistrate e re, në një gjykatë e cila nuk të ofronte mundësinë dhe komoditetin për t'u ndjerë në radhë të parë gjyqtar. Kishim vështirësi qoftë të stafit mbështetës. Ti duhet të bëje punën e sekretarit, të IT-së dhe shumë gjëra të tjera dhe për rrjedhojë edhe vështirësitë ishin të mëdha.

Megjithatë, unë e kam lexuar me vëmendje raportin, e dëgjova edhe relatorin me vëmendje. Paraqita kundërshtimet e mia që ju i keni lexuar. Me ato dy-tre çështje të cilat unë i konsiderova të rëndësishme për t'i cituar, i citova. Edhe relatorja i citoi në këtë seancë. Kryesisht u ndal në dy vendime të cilat edhe unë i kam sqaruar gjerë në kundërshtimet e mia. E para, lidhur me një vendimmarrjen time civile për kthimin e akteve, në të cilën unë kam disponuar si gjyqtare e çështjes menjëherë me kthimin e akteve sepse çdo gjyqtar e interpreton ligjin absolutisht ashtu siç është i shkruar por brenda asaj që ai e mendon se është më e mira për t'u zbatuar, duke respektuar edhe vendimmarrjen e gjykatave më të larta edhe parashikimet e tjera ligjore. Ashtu siç unë e lexoj nenin 154/a të K.Pr.Civile është që dispozita është e ndërtuar në atë lloj forme, që i jep diskrecion gjyqtarit që të vlerësojë “e kthen apo e mban padinë”. Në atë rast unë kam disponuar me kthimin menjëherë të padisë sepse kam vlerësuar që ishte rasti për t'u disponuar menjëherë me kthimin e padisë për mos me i lënë kohë për të meta sepse pala kishte depozituar në gjykatë vetëm kërkesë padinë dhe të gjitha provat i kishte fotokopje. Nuk ishte rasti që kishte paraqitur prova dhe vetëm një provë ishte fotokopje dhe unë mund të disponoja me lënien kohë dhe t'i jepja atij mundësinë.

Është e vërtetë që Gjykata Kushtetuese nuk e ka kaluar në seancë shqyrtimin e kësaj çështjeje ama siç citohet edhe në raport, më është thënë që nuk është respektuar parimi i një procesi të rregullt ligjor pasi pala është cenuar në aksesin në gjykatë, dhe Gjykata Kushtetuese për këtë cenim të këtij parimi është investuar dhe kur e ka analizuar këtë parim ka thënë që gjyqtari ka diskrecion si të vlerësojë nëse do e lërë për të meta dhe si të disponojë nëse do ta kthejë menjëherë çështjen.

Duke pasur parasysh që qytetari në momentin që i drejtohet gjykatës duhet të plotësojë edhe disa parakushte procedurale për të pasur të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata dhe për të paraqitur kundërshtimet e tij, duke pasur parasysh edhe faktin që në

këtë çështje gjyqësore, nga ajo që unë kam parë, palës nuk i cenohej asnjë e drejtë, nuk i kalonte afati për riparimitin e padisë dhe njëkohësisht në vendimmarrjen time kam cituar në vendim që pala, me marrjen e vendimit formë të prerë, ka të drejtë të paraqitet, të marrë aktet dhe ta riparaqesi padinë në momentin që ajo mendon që i ka plotësuar të gjitha të metat, kjo duke i lënë palës edhe mundësinë që ta tërhiqi padinë dhe mos të ngarkohet me detyrime financiare të tjera. Prandaj edhe për këtë pjesë kam vlerësuar që në interpretimin tim si gjyqtare e çështjes, kam zbatuar drejt parashikimet ligjore.

Lidhur me çështjen e të miturit në konflikt me ligjin është e vërtetë që në atë çështje nuk kam cituar në arsyetimin e vendimit tim lidhur me përgatitjen e raportit nga psikologu por edhe e kam cituar që ishte çështja e vetme me të mitur në konflikt me ligjin. Kjo nuk e justifikon vendimmarrjen apo mungesën e arsyetimit në vendim, por ishte çështja e vetme me të mitur që unë kam bërë në atë gjykatë për gjithë ato vite dhe absolutisht mendoj që praktika dhe mundësia për ta studiuar çështjen nëse ti ke një, dy, tre çështje, nuk është e njëjtë me faktin kur ti ke vetëm një çështje dhe ka qenë e vetmja kur ti ke shqyrtuar për këtë kategori çështjesh. Për këtë rrjedhojë kam paraqitur edhe kundërshtimet e mia lidhur me këtë pjesë.

Lidhur me “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit”, ashtu siç u citua edhe nga relatorja, jo gjithmonë ndiqej e njëjta strukturë në hartimin e një vendimi. Unë e kam cituar edhe aty në konkluzionet e mia që jo çdo kategori vendimesh mund të ketë të njëjtën strukturë organizative. Në qoftë se unë vendos për kthimin e akteve, nuk kam një pjesë procedurale që ta sqaroj se si është ecuria e çështjes dhe nëse kam një çështje tjetër e cila ka kaluar në disa faza procedurale siç mund të jetë “shtimi i objektit”, “shtimi i ndërgjyqësisë”, marrja e masave të tjera gjatë procesit, paraqitja e kërkesave të tjera, absolutisht që unë gjithmonë e kam rezervuar një pjesë për ta sqaruar se si ka qenë ecuria procedurale për këtë çështje apo faktin nëse janë kryer veprimet paraprake nga ana e gjyqtarit për secilën çështje.

Në një pjesë tjetër të raportit, ashtu siç u citua edhe nga relatorja, është marrë në analizë një vendim i imi i cili bazohej në “pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv”, ishte faturë e lëshuar nga OSHE-ja. Nuk është një rast i shkëputur me këtë lloj dhe kategori padish marrë në shqyrtim nga ana ime, qoftë edhe në gjykatën ku unë ushtroja detyrat dhe është një praktikë e cila nuk është vetëm e imja por është praktikë që e has edhe në vendime të tjera. Në këtë vendim unë kam sqaruar, ashtu siç kam sqaruar edhe në raport,

që pala i ishte drejtuar gjykatës me padi për pavlefshmëri titulli, ndërkohë që për mua fatura e lëshuar nga OSHE-ja për masën e dëmit të shkaktuar kësaj të fundit nga qytetari, nuk është titull ekzekutiv. Ashtu siç e citon edhe ligji vetë që thotë “OSHE-ja për dëmin ekonomik lëshon një faturë të posaçme e cila konsiderohet faturë dëmi dhe jo titull, dhe vetëm konsumi i energjisë elektrike (masa e konsumit) përbën titull”, unë kam disponuar në fund, mbasi kam analizuar të gjithë legjislacionin e posaçëm që rregullon këtë pjesë, me rrëzimin e padisë, për faktin se për mua kjo faturë nuk përbënte titull dhe pala duhet të ndiqte një rrugë tjetër ligjore për të kundërshtuar këtë lloj detyrimi për shkak se pavlefshmëria e titullit merret vetëm me kundërshtimin e titullit.

Pastaj, tek “ Respektimi i afateve ligjore”, u relatua se numri i çështjeve të cilat unë kisha marrë në shqyrtim gjatë kësaj periudhe ishte relativisht i ulët në krahasim me gjyqtarët në gjykata të tjera dhe për këtë shkak çështjet jashtë afatit ishin relativisht të konsiderueshme me çështjet që mund të kishte një gjyqtar tjetër. Ajo që unë dua të them është kjo që fakti që unë nuk kisha shumë çështje, të konsiderueshme në numër për t’u gjykuar, nuk ndikonte në faktin që çështjet e mia duhet të ishin detyrimisht brenda afatit, për shkak se ashtu siç e kam cituar edhe në raport, në asnjë rast nuk isha bërë unë shkak për shtyrjen e seancës ose mosmarrja e vendimeve të mia në kohë dhe sipas parashikimeve ligjore. Madje unë kam lënë seanca gjithmonë në një afat shumë të shkurtër distancë nga njëra-tjetra, ushtrija detyrën në një gjykatë që kishte vetëm një prokuror në prokurori dhe për rrjedhojë, shpeshherë seancat shtyheshin, prokurori ishte në çështje tjera, ndërrohej prokurori; kishim vështirësi shumë të mëdha me njoftimin e palëve; kishim vështirësi me paraqitjen e ekspertëve në gjykatë. Pranë gjykatës sonë nuk ushtronte detyrën asnjë ekspert. Të gjithë ekspertët vinin nga qytetet e tjera. Kishim vetëm një afat i cili asistonte gjykatën si avokat kryesisht dhe për rrjedhojë, shpeshherë pavarësisht se gjykata i merrte të gjitha masat, seancat nuk zhvilloheshin për këto shkaqe që për mendimin tim janë objektive dhe duhet të merreshin parasys.

Gjithashtu mendoj që kam ushtruar detyrën në një situatë delikate shëndetësore. Isha e deleguar në atë kohë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe çdo javë gjykoja çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, që për mua vështirësitë i ka pasur goxha të mëdhaja.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po!

Brikena Ukperaj: {...}, ti ke vajtur në 4 çështje të përfunduara në gjykatat e tjera gjatë kësaj periudhe, 4 çështje gjyqësore që janë marrë parasysh në numrin total të çështjeve.

{...}: A mund të them diçka?

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës kam pasur një çështje me 26 të pandehur, të cilët çdo javë paraqisnin kërkesa për zëvendësim mase dhe unë isha çdo javë në Kukës, pavarësisht se unë nuk e përfundova dot atë çështje, deri në ditën që u detyrova të largohesha me miratimin e Këshillit për shkak të situatës delikate shëndetësore. Kam vajtur çdo javë në Kukës, kam bërë seanca gjyqësore për atë çështje gjyqësore, dhe për dy-tre çështje të tjera që isha dhe nuk i përfundova dot.

Brikena Ukperaj: Nuk evidentohen, sepse nuk janë çështje të përfunduara këto.

{...}: Nejse, unë thjesht e parashtrova si fakt.

Brikena Ukperaj: Unë kam një pyetje.

Këtë vendimin e Gjykatës Kushtetuese ti e ke pasur parasysh kur ke marrë vendimin e kthimit të akteve dhe cila është praktika jote si gjyqtare në kthimin e akteve?

{...}: Unë e citova.

Brikena Ukperaj: E dije këtë vendimin e Gjykatës Kushtetuese?

{...}: Jo, nuk e dija, sepse nuk kishte dalë besoj në atë kohë.

Brikena Ukperaj: Po është i mëvonshëm prandaj.

{...}: Në mënyrën se si unë e interpretoj nenin 154...

Brikena Ukperaj: Si është praktika jote në kthimin e akteve?

Çfarë bën ti?

{...}: Në momentin që marr një dosje dhe e shqyrtoj, një kërkesë padi që më vjen në gjykatë, në radhë të parë shoh nëse padia është hartuar dhe është asistuar pala nga një avokat. Në rast se pala është asistuar nga një avokat, besoj që mundësia për ta ditur se cilat janë ato parakushte procedurale që duhet të plotësojë një padi për t'u paraqitur dhe për t'u marrë në shqyrtim nga gjykata janë më të larta. Për rrjedhojë në momentin që investojnë gjykatën, duhet t'i plotësojë këto të meta dhe duhet t'i plotësojë të gjitha elementët formal për të marrë padinë në shqyrtim nga gjykata. Në këtë rast, probabiliteti im për ta kthyer një padi është më i madh sesa në rastin kur padia paraqitet nga një individ dhe ajo që marr parasysh është sigurisht fakti nëse nga kthimi i akteve palës do t'i cenohet e drejta për ta riparaqitur padinë, nëse i kalon afati i parashkrimit. Në ato raste kur shoh në një vështrim të përgjithshëm, se sigurisht nuk i hyj themelit, atëherë vendimmarrja është ndryshe.

Brikena Ukperaj: Pra ti fillimisht shikon edhe afatin e parashkrimit?

{...}: Jo, unë nuk shikoj afatin e parashkrimit.

Kur lexoj padinë marr një ide të përgjithshme për të drejtën që pretendohet nga pala.

Brikena Ukperaj: Po nëse pala e ka paguar atë taksën mbi aktet, sepse kthimi i padisë në gjykatë, nuk presupozon kthimin e akteve, nuk presupozon kthimin e taksës mbi aktet. Aktet kthehen por jo taksa, jo tarifa. Mundet që një palë, po ia ktheve ti... Marrim "kundërshtimin e veprimeve përmbarimore", nuk solli asnjë provë; e ka afatin 20-ditor. Nëse ndjek këtë logjikë (sepse çështjet duhet t'i ndjekësh në të njëjtin standard), nëse do të ngrihesh logjika që do t'ia kthesh, atij i iku afati 20-ditor i kundërshtimeve të veprimeve përmbarimore.

{...}: Atëherë çfarë kuptimi ka që parashikohen disa rregulla në Kod Procedure që

pala duhet të investojë paraprakisht kur paraqet padinë.

Brikena Ukperaj: E kuptova. Unë doja të kuptoja më shumë se si ti vepron me të metat e padisë. A ke ndonjë metër, ndonjë... më thua që shikon nëse ka avokat, atëherë ia kthej se avokati duhet të dinte ligjin; shikoj afatin e parashkrimit

{...}: Qytetari do ta investojë gjykatën në çdo rast pa i plotësuar ato detyrime që ka qytetari për t'i plotësuar, të parashikuara në Kod Procedure, jo të parashikuara nga unë si gjyqtare, sepse Kodi i Procedurës thotë që në momentin që paraqet një padi në gjykatë, duhet të plotësosh disa rregulla. Të paktën unë kështu e vlerësoj. Gjithsesi, çdo gjyqtar ka qëndrimin e tij.

Brikena Ukperaj: Kopje të kërkesë padisë dhe akteve provuese, - thotë Kodi.

Mirë, unë jam e qartë për këtë pjesën e të metave.

Dua të sqaroj diçka lidhur me çështjen e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv ku nuk është shprehur lidhur me ligjërimin e masës së sigurimit të padisë. Aty, që ta kesh edhe ti të qartë, nuk është bërë vlerësimi për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Për mënyrën e zgjidhjes së çështjes ajo është pavarësi e gjyqtarit, është bindje e gjyqtarit, është mënyra se si ti e shkruan vendimin gjyqësor, se si kuptohet analiza që ti bën. Në qoftë se ti thua gjyqtari ka mjete të tjera për të zgjidhur këtë konflikt që ka, duhet t'i shkruash çfarë mjeti ka qytetari. Se s'mund të thuash "padija rrëzohet, sepse ka mjete të tjera, se ai i është drejtuar gjykatës".

{...}: ...cituat ligjin që thotë ka të drejtë administrativisht ta kundërshtojë masën e dëmit.

Brikena Ukperaj: Kaq kisha unë.

Naureda Llagami: Ndonjë koleg tjetër për pyetje dhe sqarime?

(Nuk ka pyetje nga anëtarët.)

Nëse jo, atëherë faleminderit shumë për prezencën tuaj.

Mund të vazhdoni!

(Del nga salla e mbledhjes gjyqtarja {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, fjalën e ka relatorja.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Unë prandaj edhe pasi prezantova projektraportin e vlerësimit dhe të gjitha gjetjet e mia si relatores, rezervova të drejtën për të shprehur qëndrimin tim pasi të dëgjoja edhe kandidaten, sepse jo gjithmonë diçka na del nga analiza e të dhënave statistikore.

Duke marrë parasysh fjalën e kandidates dhe kundërshtimet e saj, mendoj që të propozoj një shkallë më të lartë të vlerësimit për sa i përket “Aftësive organizative”, aty ku veprimtaria e gjyqtarit jo gjithmonë mund të matet me shifra.

Duke marrë parasysh, pavarësisht se nuk i ka përfunduar çështjet që ka qenë e deleguar, në të njëjtën kohë që ka ushtruar detyrën në Pukë, edhe në Kukës edhe në Lezhë, lidhur me “Respektimin e afateve ligjore”, propozoj që nga 6 pikë, të shkojë në 9 pikë. Është treguesi i parë i “Aftësive organizative” ose është treguesi 2A.a. Kam propozuar fillimisht 6 pikë duke mos rritur asnjë nivel pikëzimi. Mendoj që duhet të ketë një pikëzim më të lartë, në 9 pikë.

Ndërkohë, duke dëgjuar atë mbi vështirësinë e organizimit të prokurorisë dhe mungesën e ekspertëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, dhe kryesisht “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale”, për këtë tregues, është afektuar pikëzimi pikërisht nga pjesëmarrja dhe njoftimi i subjekteve procedurale që si duket nuk kanë qenë për faj të gjyqtarës, propozoj që edhe për treguesin e “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, shkalla e aftësisë të vlerësohet shumë e lartë, duke u pikëzuar me 20 pikë dhe jo me 16 pikë.

Naureda Llagami: Pra gjithsej, ajo që propozon është t’i shtohen 7 pikë.

Brikena Ukperaj: 4 pikë edhe 3, 7 (shtatë). Shkon në 94 “Aftësitë organizative” dhe shkon në "Shkëlqyeshëm". Por përsëri niveli i vlerësimit nuk ndryshon, sepse është "Shumë mirë" “Aftësia profesionale e gjyqtarës”.

Naureda Llagami: Pra nuk ndryshojmë nivel vlerësimi.

Brikena Ukperaj: Nivel vlerësimi jo. Ndryshojmë vetëm pikët.

Naureda Llagami: Dakord.

Ndonjë diskutim nga kolegët kemi?

Nëse nuk kemi dhe biem dakord me propozimin e relatores, atëherë unë propozoj që ta kalojmë në tërësi projektraportin, duke i shtuar 7 pikë magistrates, pra nga 364 në 371, por në tërësi niveli i vlerësimit mbetet i njëjtë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet raporti sipas propozimit të bërë nga relatorja, edhe për ndryshimet e tij.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.10.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

5.1 “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtarit z. {...}”.

5.2 “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

6.1 “Për caktimin në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...}”.

6.2 “Për caktimin e gjyqtares së skemës së delegimit znj. {...}, në Gjykatën Administrative të Apelit”.⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

